


# VOTA IME



# NDRYSHIMI YNË

## DEMOKRACIA DHE ZGJEDHJET

ALBERT (14), LAVDIM (13), ERONA (12), ANJESA (12), ERINA (13), SHQIPE (14), ARITË (14), ERION (13)



### Ne, nxënësit e shkollës „Teuta“ kemi marrë detyrën e gazetarëve për ditën e sotme dhe tema për të cilën kemi vendosur të shkruajmë është demokracia dhe zgjedhjet në Kosovë

Sipas fakteve dhe njohurive të cilat i kemi rreth demokracisë, ato na tregojnë se demokracia ka lindur në Greqi, përkatësisht në kryeqytetin e saj në Athinë, në vitin 507 p.e.s. Rreth lindjes së demokracisë kemi edhe historinë e saj. Kur Athina nuk kishte popullsi të dendur, qytetarët e saj erdhën në një mendim që për marrjen e vendimeve për qytet, të marrin pjesë të gjithë qytetarët e Athinës, përveç të moshuarve, grave dhe personave nën moshën 18 vjeçare. Ata së pari shprehën mendimet e tyre rreth një çështje. Pasi kishte mendime të ndryshme, ata votuan në mënyrë të drejtpërdrejtë për marrjen e vendimeve. Kjo mënyrë e qeverisjes u quajt demokraci direkte, por me kalimin e kohës u bë e vështirë që të praktikohet kjo mënyrë e

qeverisjes për arsye se popullsia e Athinës shënoi rritje. Forma e dytë e demokracisë u quajt demokraci përfaqësuese, e cila erdhi më vonë, ku në vendimmarrje përfshihej i gjithë populli. Sipas bisedës tonë, ne kuptuam se në demokracinë përfaqësuese, qytetarët votojnë për zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre.

Në demokracinë përfaqësuese parlamentare, siç është edhe shteti ynë Kosova, përmes zgjedhjeve ne votojmë për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Gjithsej Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, prej tyre 100 janë qytetarë shumicë, kurse 20 të tjerë janë qytetarë nga komunitetet jo shumicë të Kosovës. Këto zgjedhje quhen zgjedhje qendrore. Ndërsa, në zgjedhjet lokale apo komunale ne zgjedhim kryetarin e komunës dhe asamblenë komunale.

Përveç këtyre zgjedhjeve ne bëjmë zgjedhje të përditshme, për shembull rrobat që i veshim, librat që i lexojmë etj. Prandaj, zgjedhjet janë kudo rreth nesh.



Gazetarët e artikullit mbi demokracinë




Shkrimet tona mbi zgjedhjet demokratike



Demokracia na ofron mundësinë e argëtimit dhe lumturisë



Përgjegjësia jonë është të mos e ndotim ambientin



Mendimet tona rreth demokracisë, Kuvendit si dhe zgjedhjeve




Grupi duke punuar rreth artikullit



Gazetarët e Kuvendit

## SHTËPIA E POPULLIT

GENITA (14), LEONITI (14), KALTRINA (14), ENDRITI (14), DRILONA (14), ERMIRA (15), ALBINI (14)



### Në artikullin tonë do të informoheni më shumë rreth asaj se si funksionon Kuvendi i Kosovës dhe cilat janë disa nga funksionet e tij

Kuvendi i Kosovës është një ndër institucionet më demokratike në vendin tonë. Si i tillë ka disa funksione që janë shumë të rëndësishme, e ato janë: miratimi i ligjeve (funksioni legjislativ), ligje këto të propozuara



nga vetë deputetët, por edhe nga Qeveria; përfaqëson popullin, sepse deputetët e përfaqësojnë popullin i cili ia ka besuar votën; si dhe mbikëqyr Qeverinë, këtë e bën nëpërmjet pyetjeve që i parashirohen ministrit të Ministrisë përkatëse.

Në seancat e Kuvendit, përpos deputetëve, bëjnë pjesë edhe ministrit, Kryetari i Kuvendit, nënkryetarët, drejtori ligjor, etj. Numri i deputetëve në Kuvendin e Kosovës është 120, ku 100 prej tyre i përkasin kombit shqiptar, kurse 20 prej tyre janë nga

etnive të tjera (10 nga ta janë serbë, kurse 10 të tjerë egjiptianë, romë, turq, ashkalinjë, goranë). Pozitë quajmë partinë që ushtron pushtetin dhe ka fituar më së shumti vota në zgjedhje. Ndërsa, opozitë quajmë partinë që kanë fituar më pak vota sesa partia e pozitës.

Në Kuvend, partinë pozitë kanë pjesën më të madhe të ulëseve. Deputetët në Kuvendin e Kosovës, miratimin e ligjeve e bëjnë me shumicë të thjeshtë dhe me shumicë të kualifikuar. Seancat plenare mbahen një herë në javë, por në rast të seancave të jashtëzakonshme, seancat mbahen dy-tri herë në javë. Nga gjithë kjo që u tha, vijmë në përfundim se Kuvendi i Kosovës punon për të mirën e qytetarëve, sepse edhe vetë përfaqësuesit e Kuvendit zgjedhen nga vota e popullit.

Pa Kuvendin, sistemi i një shteti nuk mund të funksionoj siç duhet.



Autorët e artikullit

# QYTETARËT E LIRË DHE AKTIV

EDONA (13), YLLKA (10), ELSA (12), ERJON (12), VIOLA (12), FISNIK (12), ANDI (12), ERINA (12)



Qytetaria aktive shkruar nga ne



Ne e kemi përgjegjësi ta mbajmë ambientin e pastër

## Ne jemi nxënësit e shkollës fillore „Teuta“ dhe sot kemi mësuar për qytetarinë aktive. Më poshtë mund ta lexoni artikullin tonë


Çka do të thotë të jesh qytetar? Qytetar do të thotë të jesh pjesë e një shteti dhe të kesh leje qëndrim në atë vend. Pra, ne të gjithë jemi qytetarë të Kosovës. Prandaj, ne si qytetarë të një shteti demokratik, kemi të drejta dhe përgjegjësi. Disa nga të drejtat tona janë: e drejta për shkollim, e drejta e identitetit tonë apo emrit, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e argëtimit ose lojës, e drejta e strehimit, etj. Ndërkaq, përgjegjësitë tona janë: ruajtja e ambientit dhe mbajtja e pastërtisë, respektimi i ligjit, pagesa e taksave, respektimi i objekteve publike, etj. Ne edhe tani, edhe kur të rritemi do të jemi aktiv për të mirën e vendit tonë. Ne vlejme.



Gazetarët e artikullit „Qytetarët e lirë dhe aktiv“ Të lumtur që sot patëm mundësinë të jemi gazetarë



Ne kemi përgjegjësi dhe i respektojmë ato



Unë e kam lirinë e shprehjes. Mos ma e mohoj atë!



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Teuta“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1 & VII-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Grashticë, Prishtinë